

## AKT THEMELIMI

### Per krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

#### "DODBIBA" sh.p.k

Sot , ne daten 07/07/2014 :

Z. Genti Dodbiba i biri i Anastasit i datelindjes 01.03.1970 lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane Rr. Hoxha Tahsim nr 24 mbajtes i Leternjoftimit nr. 028930203 Vendors te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "DODBIBA" Sh.p.k si me poshte vijon :

#### Neni 1

Shtetasi i siperpermendur, me vullnet te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar krijon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "DODBIBA" Sh.p.k. Ortak i vetem i shoqerise eshte Genti Dodbiba me 100% te kapitalit.

Administrator i Shoqerise "DODBIBA" sh.p.k eshte z. Genti Dodbiba, i cili emerohet ne kete detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

#### Neni 2

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "DODBIBA" Sh.p.k gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te ketij akti, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi.

Selia e Shoqerise "DODBIBA" sh.p.k eshte ne : Rr. Hoxha Tahsim nr 21, Tirane. Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti themelimi (kontrate) dhe eshte pjese perberese e tij.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen : "DODBIBA" SH.P.K.

#### Neni 3

Veprimtaria e Shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te Shtetit dhe do te vazhdoje per nje afat te papercaktuar.

#### Neni 4

Shoqeria "DODBIBA" Sh.p.k ka si objekt te veprimtarise ekonomike :

- Hapjen e institucioneve te arsimit parashkollor dhe parauniversitar.



- Aktivitet ne fushen e hotelerise dhe turizmit
- Tregetim me shumice dhe pakice te materialeve qe sherbejne ne funksion te veprimtarise se shoqerise
- Transport urban dhe interurban, brenda dhe jashte vendit, mallrash dhe pasagjeresh, per nevoja te shoqerise dhe te te treteve.

#### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke (njqind mije leke). Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1000 leke (nje mije) per cdo kuote, i shlyer dhe i nenshkruar teresisht nga ortaku. Pjesemarrja e ortakut ne kapitalin themeltar eshte si me poshte :Ortaku i vetem eshteGenti Dodbiba me 100 %, barabarte me 100 kuota.

#### Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakut te siperpermendur sipas kontributit perkates.

#### Neni 7

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaku nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

#### Neni 8

Marredheniet e punes ne shoqeri ose/dhe ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit perkates ne fuqi.Dispozita te hollesishme mbi organizimin e shoqerise percaktohen ne statutin e saj.

Ky akt themelimi behet ne 4 (kater) kopje.

**Ortaku i vetem (Administrator)**

**Genti Dodbiba**



**STATUT**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**